



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverballi i mbajtur më 28 korrik 2016, në mbledhjen e XXX-të
(tridhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalju, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, , Agron Gërguri, i autorizuar për ushtrimin e detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, pas dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje të nesërmen është paraqitur nevoja dhe u është dërguar materiali edhe për një pikë shtesë të rendit të ditës dhe atë:

- **Propozim vendimi për mbështetje financiare Teatrit e Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë**

z. Rafet Llapashtica, theksoi, duke ardhur në këtë mbledhje më informoi z. Fadil Mulliqi, sekretar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës se e ka dorëzuar një kërkesë për mbështetje financiare në shumë diç mbi 1.700 €, për shqyrtim në Kuvend të Komunës, kërkesë të cilën ua ka dërguar edhe Grupeve të këshilltarëve të përfaqësuar në Kuvend, andaj jam i interesuar të di përse kjo çështje nuk është propozuar në rend dite.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, pas miratimit të rishikimit të buxhetit për vitin 2016 kanë arritur dy kërkesa, njëra e Shoqatës së Veteranëve të Luftës e tjetra e Shoqatës së

Invalidëve të Luftës. Meqë rishikimi i buxhetit është miratuar si konkluzion për këtë çështje të jetë që kërkesa t'i dërgohet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me shqyrtim të mundësive që këto shoqata të ndihmohen nga buxheti i paraparë për subvencione.

z. Naim Qunaku, theksoi, ne e kemi miratuar dhe është në fuqi Rregullorja për ndarjen e subvencioneve, në të cilën janë të përcaktuara procedurat dhe kriteret për ndarjen e subvencioneve, andaj në kuadër të kësaj Rregulloreje duhet të shikohen mundësitë për mbështetje financiare shoqatat e cekura.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar i ditës së bashku me pikën shtesë u miratuan njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa më 24 maj 2016 dhe 28 qershor 2016

Ekstraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri.

3. Raporti financiar për periudhën janar – qershor 2016

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, i sqaroi çështjet përkatëse mjaftë mirë, andaj duke u bazuar në pasqyrimin e qartë të realitetit, Grupi i këshilltarëve i LDK – së nuk ka të shtojë asgjë tjetër. Konsiderojmë se është mirë që po raportohet në periudha të caktuara kohore e me këtë përmbushet edhe ky obligim ligjor. Na mbetet vetëm ta falënderojmë drejtorin për një punë mjaftë të mirë që është duke u bërë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dëshiroj t'ju marrë kohë andaj do të përqendrohem vetëm në disa vërejtje dhe atë të shpenzimet e të hyrave vetanake ku nga shuma 6.590 €, 6.356 € janë për pagesë të punës me kontratë, edhe pse nga auditori është bërë vërejtje për angazhim të punëtorëve me kontratë mbi vepër, kjo është dëshmi se të hyrat vetanake nuk menaxhohen mirë. Pastaj për shpenzimet e shërbimeve të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, nuk jam në dijeni se për cilën Drejtori kanë të bëjnë, por shpenzime afërsisht të njëjta janë në çdo gjashtëmuor, andaj kërkoj të jepen sqarime konkrete se për çfarë këshillash intelektuale bëhen pagesat përkatëse.

Te shpenzimet e telefonisë mobile në vazhdimësi kemi rritje edhe pse telefonia fikse është më e lirë nuk përdoret por për komunikim përdoret telefonia mobile e jemi në dijeni se në kuadër të telefonisë mobile jemi të lidhur të gjithë këshilltarët e Kuvendit, Ekzekutivit dhe shërbyesve civil dhe komunikimet i bëjmë pa pagesë, andaj shpenzimet në shumë prej 5.000 € për këtë qëllim sipas mendimit tim nuk mund të arsyetohen.

Vërejtja më e madhe është për Drejtorinë e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë rreth menaxhimit të kontratave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim ngase arkëtimi i qirasë është shumë i ulët por ka raste që shfrytëzuesi pronën e Komunës e shfrytëzon mëse 10 vite e nuk ka bërë fare pagesë të qirasë e në anën tjetër ka ofertues mjaftë serioz të cilët në mënyrë të rregullt do të paguanin qiranë por janë eliminuar nga komisione të ndryshme për dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas materialit për të cilën jemi duke debatuar, për mua shqetësuese është dinamika e shpenzimeve për investime kapitale meqë nga shuma 5,001,953 € janë shpenzuar 434,935 €, kur dihet se qytetarët e Komunës së Podujevës

kanë shumë nevojë për investime në sektor të ndryshëm qoftë në shëndetësi, arsim, bujqësi, infrastrukturë, kanalizime etj. Gjithherë kam thënë se problem do të ishte nëse nuk do të kishim mjete dhe nuk e kuptoj përse tash problemi paraqitet për shpenzimin e mjeteve përkatëse.

Sipas raportit vërehen disa zvogëlime të shpenzimeve siç është rasti i udhëtimeve jashtë, kuptohet edhe mëditjeve, megjithatë në disa kode ka ngritje dhe atë për naftë për ngrohje Qendrore kemi ngritje për 63.23%, dru për 28.94%, pastaj për mirëmbajtje të automjeteve kemi ngritje për 164.50% krahasuar me vitin e kaluar.

Pagesa për përfituesit individual përmendet në tri kode, lidhur me këtë do duhej të jepen sqarime për natyrën e këtyre shpenzimeve.

Sa i përket punës me kontratë mbi vepër konsideroj se është e nevojshme të jepet përgjigje konkrete dhe serioze ngase për këtë çështje kemi vërejtje edhe nga Auditori.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, fillimisht do të jap sqarime sa i përket pyetjes lidhur me përfituesit individual, siç u tha përmenden në tri vende, përfitues individual prej buxhetit janë studentët dhe nxënësit për bursa, mirëpo studentët dhe nxënësit sërish janë përfitues prej të hyrave vetanake dhe së fundi përfitues individual janë personat me gjendje të rëndë sociale të ndihmuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shpenzimet për shërbime intelektuale në shumë prej 930 € ky shpenzim ka ndodhë në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për një manifestim të organizuar, ndërsa shumat tjera janë në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të realizimit të projektit në Sfeçël për trajnimet e mbajtura nga një kompani e cila paguhet për punën e vet kuptohet në bazë të kontratës.

Shpenzimet telefonike kanë rënë për -46% për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa te shpenzimet e telefonisë mobile është një rritje prej 31% dhe nëse gërshetohen njëra me tjetrën rezulton se ka zvogëlim të shpenzimeve.

Te shërbimet kontraktuese nuk janë vetëm shpenzimet për punëtorët me kontratë mbi vepër por ka edhe shpenzime të tjera përkatësisht të gjitha pagesat të cilat nuk e kanë një emër adekuat përkatësisht kontratat të cilat nuk mund t'i quajmë as për pajisje e as për furnizim, shpenzimet barten te shërbimet kontraktuese të tjera.

Sa i përket shpenzimeve për dru për ngrohje, furnizimi me dru është i njëjtë, e për shkollë mund të ketë edhe rënie, mirëpo shpenzimet janë rritë për shkak të bartjes së borxheve nga vitet e kaluara, ngase jeni në dijeni se sa herë kemi debatuar për buxhet është ngritë çështja e mungesës të buxhetit në Drejtorinë e Arsimit në veçanti kategorinë për paga dhe mëditje dhe kategorinë mallra dhe shërbime, ndërsa investimet kapitale janë në kuadër të buxhetit të MASHT – it.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, Raporti financiar paraqet gjendjen reale të të gjitha shpenzimeve përkatësisht pagesave.

Jam i mendimit se te investimet kapitale për periudhën gjashtëmujore është shkallë e ulët e shpenzimeve, edhe vitin e kaluar ka qenë e tillë, mirëpo bazuar në përvojën time mund të them se në muajt e parë të vitit bëhen përgatitjet për zhvillimin e procedurave për tenderim duke përfshirë edhe lidhjen e kontratës dhe kjo zgjatë deri në muajin e katërt apo të pestë dhe pagesat bëhen pas përfundimit të punëve përkatëse. Drejtorët e Drejtorive kompetente duhet të kenë kujdes në mënyrë që të mos krijohet suficit i mjeteve në kategorinë e investimeve kapitale, andaj është i nevojshëm angazhimi maksimal për realizimin e projekteve të planifikuara.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, diskutimin tim do ta rezervoj për mbledhje të Kuvendit, mirëpo kam pasë disa pyetje për z. Abaz Llugaliun, i cili nuk është i pranishëm në këtë mbledhje, andaj kërkesa ime është që i njëjti nëse nuk është i zënë me punë të tjera zyrtare të jetë i pranishëm në mbledhjen e Kuvendit në mënyrë që të përgjigjet në pyetjet të cilat do t'i shtrojë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në mbledhjen e nesërme të Kuvendit janë të obliguar të marrin pjesë të gjithë drejtorët e Drejtorive, ngase Raporti i auditorit përfshinë çështjet të cilat ndërliken me punën e të gjitha Drejtorive.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se kur debatojmë për raportin e Auditorit të Përgjithshëm duhet të jetë i pranishëm Kryetari i Komunës ngase raporti i referohet Kryetarit të Komunës e jo drejtorëve të Drejtorive, të cilët në mungesë të Kryetarit mund të japin sqarime të ndryshme.

Në fillim të Raportit thuhet se opinionimi është i pamodifikuar, mirëpo shtohet se është me theksim të çështjes e kjo nënkupton realisht se ka edhe anë negative.

Edhe më herët e kam përmendur çështjen e subvencioneve, madje për mbikëqyrjen e ndarjes së subvencioneve, kam kërkuar ngritjen e një komisioni nga përbërja e Kuvendit, komision të cilin e kanë shumica e komunave në Republikën e Kosovës. Tani në Raportin e auditimit del vërejtje lidhur me ndarjen e subvencioneve, unë po e përmendi vetëm një shembull dhe atë prej 120 fermerëve të cilët kanë aplikuar 90% e tyre i kanë plotësuar kushtet ndërsa kanë përfituar 30 fermerë, andaj sikur të ishte Komisioni i ngritur prej Kuvendi përzgjedhja do të ishte më e lehtë.

Çështje tjetër negative, sipas këtij raporti, janë kontratat për shërbime të veçanta, pastaj te prokurimi dhe te arkëtimi i të hyrave vetanake që për këtë të fundit rezulton se Drejtoria përkatëse nuk është aktive sa duhet në arkëtimin e të hyrave vetanake.

Nga dhënia në shfrytëzim të paluajtshmërive në pronësi të Komunës janë planifikuar 60.000 €, detyrimet sipas kontratave kanë qenë 132.794 €, ndërsa është inkasuar shuma prej 59,579 €, çështje e cila sipas mendimit tim duhet të debatohet.

Po ashtu në tri raste komuna kishte lidhë kontrata në vitin 2012 për dhënie në shfrytëzim të lokaleve afariste. Kontratat nuk ishin zbatuar pasi që qiramarrësit nuk kishin bërë pagesat sipas kontratës. Borxhi total i grumbulluar ishte 25,726 €. Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr asgjë për t'i obliguar këta qiramarrës që t'i kryejnë obligimet e tyre ndaj Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit z. Mehmet Gashi, theksoi, në mbledhjen e nesërme të Kuvendit sigurisht do të marrin pjesë edhe Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës dhe shtoi, pasqyrat financiare të paraqitura në këtë raport janë ato që janë dhe nuk mund të ndryshohen por mbetet obligim që rekomandimet e dhëna të përmbushen.

Pas votimit u konstatua se raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Informatë për përfundimin e vitit mësimor 2015 / 2016

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është e paraparë në Planin e punës së Kuvendit, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e ka përmbush obligimin e vet dhe e ka përgatitur këtë informatë duke përfshirë edhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017.

z. Haki Rudari, theksoi, mua më kënaq fakti se tani po paraqiten informata për lëmin e arsimit, kemi pasë Informatën rreth përfundimit të gjysmëvjetorit të parë e tash e kemi Informatën për përfundimin e vitit shkollor dhe shpresoj se do ta kemi edhe Informatën për përgatitjet lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017, në mënyrë që përmes kësaj informate të njoftohemi qoftë për anë pozitive qoftë për anë negative. Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i Vendimit për mbështetje financiare Teatrit e Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë

z. Agron Gërguri, i autorizuar për ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse. Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13.50’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-59367
Podujevë,
28 korrik 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**